



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

Vendim

Nr. 145, Datë 18.09.2017

**PËR
MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI PROCEDURAT PËR PARAQITJEN E NJË
KËRKESË, SHQYRTIMIN E SAJ DHE AFATET E NJOFTIMIT KUR KLIENTI
DYSHON NË SAKTËSINË E TË DHËNAVE TË APARATIT MATËS TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”.**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20 gërma “a” dhe 77, pika 6; neni 108, pika 3 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi draft – Rregullores “*Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike*”, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

Konstatoi se :

- Me Vendimin 67, datë 27.05.2016 Bordi i ERE-s, vendosi: “Fillimin e procedurave për miratimin e “*Rregullores mbi procedurat për paraqitjen e një ankese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike*”.
- Me shkresën Nr.430 Prot, datë 01.06.2016, ERE u ka dërguar të gjitha palëve të interesuara, draft Rregulloren “*Mbi procedurat për paraqitjen e një ankese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike*”
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë, me shkresën Nr.3785/1 Prot, datë 06.07.2016, është shprehur parimisht dakord mbi miratimin e kësaj rregullore, duke paraqitur propozimet e saj mbi disa ndryshime dhe saktësime, të cilat janë reflektuar në rregullore.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, me shkresën Nr. 4530/1 Prot, datë 21.06.2016 ka shprehur opinionin dhe sugjerimet e saj, të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar në Rregullore.

- Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, me shkresën nr. 2601/1 Prot, datë 07.06.2016, është shprehur dakord me të gjithë përmbajtjen e rregullores.
- “Operatori i Sistemit të Transmetimit” shkresën me nr. 3962/1 Prot, datë 25.07.2017, ka shprehur opinionet dhe qëndrimin e saj, i cili është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë Rregulloren “*Mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike*”. Bashkëlidhur
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë te interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI